



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E SHKENCAVE

ASAMBLEJA

Nr. ~~606~~ prot.

Tiranë, më 22.4.2024

Vendim

Nr. ~~44~~ datë 22 prill 2024

**Për miratimin e konkluzioneve të bordit të drejtorëve në lidhje
me autonomitë dhe lirinë akademike**

Asambleja e Akademisë së Shkencave, e mbledhur më datë 22 prill 2024, pasi u njoh me konkluzionet e mbledhjes së bordit të drejtorëve (shkresa me nr. prot. 518, datë 9.4.2024 bashkëlidhur) në lidhje me respektimin e cënimit ose jo të lirisë dhe autonomisë akademike nga auditimet e performancës së kërkimit shkencor e konkretisht të auditimit me temë: *Projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave, në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjik dhe inovacionit, për të mirën e vendit*, njoftuar me shkresën me nr. 416 prot., datë 25.3.2024, nga KLSH, duke i vlerësuar ato si të drejta e të rëndësishme për mbrojtjen e lirive akademike jo vetëm të Akademisë e njësisive pranë saj, por të institucioneve të kërkimit shkencor në tërësi,

Vendosi:

1. Të arrijë në të njëjtat konkluzione, si më poshtë:

Asambleja e Akademisë së Shkencave vlerëson se auditimi i performancës së kërkimit shkencor e posaçërisht i rezultateve të tij është atribut vetëm i komunitetit shkencor e kryhet nëpërmjet ballafaqimit e debatit shkencor në aktivitete shkencore e botimeve të specializuara e nga strukturat e ngritura posaçërisht për akredimin e rankimin e

institucioneve e njësive kërkimore-shkencore dhe punonjësve kërkimorë-shkencorë.

Çdo formë tjetër kontrolli i programit, produktit e metodologjisë shkencore, veçanërisht i ushtruar nga organe të administratës shtetërore, përbën cenim të hapur të lirive akademike në kërkimin shkencor të njohura e mbrojtura nga deklarata e Bonit e UE, Kushtetuta e Shqipërisë, ligji për shkencën, ligji i Arsimit të Lartë e ligji e statuti i ASH dhe njësive të kërkim-studimit.

Në respektim të këtij parimi vetë institucionet kërkimore-shkencore nuk ushtrojnë kontroll ndaj njëra-tjetrës, as ndaj strukturave përbërëse për sa i takon produktit shkencor; dhe ligji i ASH e thotë qartë se, njësitë e kërkim-studimit janë autonome në veprimtarinë kërkimore-shkencore, ndonëse ngrihen prej saj e financohen prej saj, ndërkohë ato bashkëpunojnë si për realizimin e programeve të përbashkëta e informojnë ndësjelltas në realizimin e tij.

2. Qëndrimi i Asamblesë së ASH-së t'i bëhet i njohur Kontrollit të Lartë të Shtetit;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave.

KRYETARI

Akad. Skënder GJINUSHI

